

KONTRATA PËR FURNIZIM

E lidhur në Lipjan ndërmjet palëve kontraktuese më 04/12/2019

Emri i Autoritetit Kontraktues> Komuna e Lipjanit përfaqshuar nga drejtosi i Drejtoria e Prokurimit z.Adem Duriqi në vazhdim (permendet) Autoriteti kontraktues Dhe

<Emri i Kontraktuesit> " ETIANI, ISTOG, 31000, ISTOG të cilin e përfaqëson Naim Selmanaj, drejtor në vazhdim përdoret (shkurtesa) ("Kontraktuesi"),

Furnizimi me antifriz per ngrohjet qendrore

me numër Identifikues 613-19-8136-1-3-6 numër te brendshëm te prokurimit 613 019 124 136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës , furnizimi me ekoantifriz për sistemet e hapura dhe të mbyllura të ngrohjes qendrore. EKOFRIZ është një antifriz i bazuar në glikol propilen . EKOFRIZ përmban të gjithë inhibitorët e nevojshme të korrozionit dhe kështu mbron nga të gjitha materialet e lidhura me korrozioni të përdorura në sistemet e ngrohjes dhe të ftohjes si bakër, çelik, bronzi, alumin, gome, plastikë etj.Ai është i përshtatshëm për sistemet ku ekziston mundësia e përzierjes me ujë të pijshëm (për shkak të ndërprerjes së tubit).

JO TOXIC. Nuk përmban nitrite, amine dhe fosfate (falas NAP)

Vetitë e antifrizit: Viskoziteti (⁰E/eSt) në 20 ⁰C, Viskoziteti (⁰E/eSt) në 40 ⁰C, Viskoziteti (⁰E/eSt) në 100 ⁰C, Indeksi minimal i viskozitetit, Pika minimale e ndezjes (+⁰C), Prezenca maksimale e ujit në (%), Papastërtia mekanike në (%), Numri neutralizues (mg KOH/g) –TBN, Dendësia 15 C (gr/cm³), Dendësia 20 C (gr/cm³) , Depërtimit në 25⁰C(mm/10), Temp. e ngrirjes në tretjen me ujë 1:1 (< -33 ⁰C) (⁰C), Pika minimale e vlimit (>160⁰C), Dendësitë 20 ⁰C (gr/ml), Prezenca e zinkut max. Pika e ngrirjes në - Indeksi cetanik min. Tem e ngrirjes (⁰C), Pika e ngjizjes (⁰C)

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 3 ditë pas nënshkrimit] dhe përfundon me 10 ditë pas nënshkrimit].

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 10] ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i [dërgimit të furnizimeve] do të jetë depo e QKMF-së dhe depo e komunës së Lipjanit

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm i kontratës shprehur me shifra është: **6.596,00 €**; apo shprehur me fjalë gjashtëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë. Euro e zero centë.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës] do të faturohen sipas zotimeve nëpër njësi, dmth siq janë zotimet

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara nënemi 1 të kësaj kontrate dhe në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që me rastin e pranimit të mallit të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, që ofrohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërrprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërrprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykata themelore në Lipjan ose Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Naim Selmanaj	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04. 05. 2019	Data:	
Vula:		Vula:	



Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ² - €	Çmimi total €	Koha e dërgesës
1.	Furnizimi me antifriz i bazuar ne glycoli(mono e thylene glycole) për ndemjet qendrore	KG	4850	1.36	6596.00	10 ditë
Totali i Përgjithshëm:					6596.00	

² Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.